

VENDIM

Nr. 152, datë 13.3.2018

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 135, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LEJIMIN E
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË, PËR DISA MALLRA
E SHËRBIME"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës "a", të pikës 4, të vendimit nr. 135, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "a/1", me këtë përmbajtje:

"a/1) të lidhë kontrata të posaçme me prodhues të barnave (*Managed Entry Agreements* ose *MEA*), në kushtet e nenit 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar, në këto raste të veçanta:

- i) Kur bari mund të sigurohet vetëm nga një prodhues, i cili zotëron të drejtat ekskluzive mbi atë bar;
- ii) Kur përdorimi i teknologjisë së barit mund të rrisë efikasitetin e trajtimit të pacientëve në spitalet publike dhe kur bari është alternativë e vetme për një sëmundje ose indikacion të caktuar;
- iii) Për sasi të garantuara bari, me çmim më të ulët se ai i deklaruar, miratuar nga ministria."

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe spitalet publike në varësi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**